



02Nr 3115 /2024
24.04.2024

Duke u bazuar në nenin 95 , nenin 96, nenin 97 dhe nenin 103 paragrafi 2 të Ligjit numër 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenin 7 dhe 8 të Rregullores (QRK) numër 05/2022 për Procedurat Konkurruese dhe Pranimi për Nëpunësit Administrativ dhe Mbështetës, Komuna Hani i Elezit shpallë këtë:

K O N K U R S

Për plotësimin e vendit të lirë të punës

Titulli i vendit të punës: **Punëtor Teknik**
Institucioni: **Komuna Hani Elezit**
Drejtoria: **Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport**
Njësia sektori: **Kulturë**
Lloji i pozitës: **Nëpunës administrativo-teknik**
Numri i pozitave: **Një (1) pozitë**
Orari i punës : **40 orë në javë**
Titulli i mbikqyrësit: **Drejtori i drejtorisë**
Koeficienti/Grada: **GJ 51 3.76**
Kohëzgjatja: **pa caktuar**

- **Përshkrimi i përgjithshëm i punës:**

1. Kujdeset për mirëmbajtjen e objektit në pjesët e jashtme dhe të brendshme;
2. Bën mirëmbajtjen e instalimit elektrik, ujit, inventarit dhe pajisjeve tjera;
3. Në rast të defekteve të mëdha, mban kontakte me serviset e specializuara dhe asiston me rastin e riparimeve;
4. Bën kyçjen dhe çkyçjen e nxemjes qendrore dhe gjeneratorit elektrik, duke mbajtur edhe evidencën e derivateve të naftës të cilat janë të deponuara në rezervuarët e këtyre pajisjeve;
5. Mban evidencën, kontrollon dhe monitoron rezervuarin e derivateve të cilat janë të vendosura në lokacionet e objektit;
6. Bën mirëmbajtjen e oborrit dhe përkujdeset për lulet brenda dhe përreth objektit;
7. Kryen edhe detyra tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret ;

- **Kërkesat e përgjithsme për pranim:**

- a. Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- b. Të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
- c. Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- d. Të jetë i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- e. Të mos jetë i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- f. Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- g. Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës;
- h. Të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në Ligjin për Zyrtarët Publik.

- **Kërkesat e përgjithshme formale:**

- a. Arsimimi i kërkuar: **Shkollimi i mesëm**
- b. Përvoja e punës e kërkuar: **Nuk kërkohet**

- **Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme:**

- a. Aftësi për zbatimin e procedurave dhe udhëzimeve administrative për kryerjen e detyrave të punës;
- b. Të jetë i qëndrueshëm në punën me presion të kohës dhe orare të zgjatura dhe të jetë fleksibil në orare;
- c. Shkathhtësi komunikimi, përfshirë aftësinë për të interpretuar informata, dhënë udhëzime dhe përcjellë informata tek të tjerët.

- **Dokumentet që duhet paraqitur për aplikim:**

- a. Formulari i aplikimit, i plotësuar (merret në Komunë-Qendra për Shërbim me Qytetarë) ;
- b. Rezumeja personale (CV)
- c. Kopjet e dokumentit personal (letërnjoftim ose pasaportë);
- d. Dëshmi mjekësore se kandidati është në gjendje të mirë shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse
- e. Dokumenti që nuk jeni dënuar me vendim të formës së prerë (lëshuar nga Gjykata Themelore, jo më i vjetër se 6 muaj);
- ë. Kopjet e dëshmisë së punësimit (nëse posedon) ;
- f. Kopjet e dëshmisë së trajnimeve (nëse posedon) .

- **Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve:**

- a. Vlerësimi i jetëshkrimit (deri në 30 pikë)
- b. Intervistë me gojë (deri në 70 pikë)

- **Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët dhe shpallja e rezultateve përfundimtare:**

-Përmes web faqes së Komunës së Hanit të Elezit dhe portalit për rekrutim elektronik.

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Pranimi i aplikacioneve bëhet brenda tetë (8) ditëve nga data 09.05.2024 deri 16.05.2024

Mirëpriten aplikacionet e femrave dhe meshkujve të të gjitha komuniteteve të Republikës së Kosovës.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Konkursi dhe rezultatet shpallen në linkun: <https://konkursi.rks-gov.net/> , në webfaqen e komunës <https://kk.rks-gov.net/haniielezit> dhe në tabelën e shpalljes.

